



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

Nr. 26/2, DATË 20/11/ 2017

PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “SARANDA MARINA RESORT & SENIOR HOUSING”

Në mbështetje të Nenit 9, pikës 5 të nenit 17 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015, Komiteti i Investimeve Strategjike,

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Saranda Marina Resort & Senior Housing”, me subjekt investues Concord Investment NUIS/NIPT: K81602049K në procedurën e asistuar.
2. Projekti i investimit “Saranda Marina Resort & Senior Housing” vlerësohet i pamaturuar. Plani zhvillimor i projektit Saranda Marina Resort shtrihet në Zonën Kadastrale Nr. 8642 Sarandë dhe përfshin zonën e ish – Repartit Ushtarak në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes, zonën e portit të peshkimit dhe zonën e kalatës tregtare të Portit të Sarandës në pronësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ky projekt investimi është në mospërputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë. Kriteret teknike të PPV Sarandë parashikojnë që destinacioni i zonës është rekreacioni/rigjenerimi urban, dhe jo banim e resort që do ta kthenin zonën në territor privat me përdorim të kufizuar.
3. Vendimi i KIS publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet me shkrim kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

SENIDA MESI